



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 236

Tiranë – E enjte, 4 janar 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 29.12.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 918, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike” 13117
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 797, datë 29.12.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar..... 13117
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 809, datë 29.12.2017	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 3.12.2015, për çështjen “Bici kundër Shqipërisë” (për ankimin nr. 5250/07) 13130
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 811, datë 29.12.2017	Për miratimin e buxhetit të vitit 2018 për Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme..... 13131
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 812, datë 29.12.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 245, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës së koncerteve të Pallatit të Kongreseve, Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor” 13133
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 813, datë 29.12.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar..... 13133
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 814, datë 29.12.2017	Për një shtesë në vendimin nr. 61, datë 3.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paketave të pajisjeve mjekësore të rimbursueshme” 13135
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 29.12.2017	Për disa shtesa në vendimin nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në shërbimin spitalor”, të ndryshuar..... 13136

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 29.12.2017	Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të pasurisë nr. 1/586+1-2, zona kadastrale nr. 8380, Tiranë, për t'u përdorur si seli e Sekretariatit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor.....	13138
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 818, datë 29.12.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar.....	13141
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 819, datë 29.12.2017	Për dhënie shtese pensioni të posaçëm shtetëror z. Mirush Musa Kabashi.....	13141
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të zhdukur të shtetases Tefta Kallaku.....	13141



VENDIM

Nr. 796, datë 29.12.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 918, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRYERJEN
E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT
PUBLIK NË MËNYRË ELEKTRONIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22, pika 1, dhe 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 2, të vendimit nr. 918, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM¹

Nr. 797, datë 29.12.2017

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 914, DATË 29.12.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE
TË PROKURIMIT PUBLIK”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullave të prokurimit publik, bashkëlidhur vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2, “Prokurimi i përqendruar”, bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe zëvendësohet me “Prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit”.

2. Në pikën 1, pas fjalëve “... ose shërbimeve të njëjta ...” shtohen “..., si dhe/ose lidhjen e marrëveshjes kuadër për punë, furnizime ose shërbime të caktuara ...”.

3. Pas paragrafit të parë, të pikës 2, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Ministritë ose institucionet e tjera, që kanë në varësi disa autoritete kontraktore, mund të prokurojnë në mënyrë të përqendruar për autoritetet kontraktore të varësisë.”.

4. Pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Nëse një ose disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë mall/punë ose shërbim, ata mund të bien dakord të delegojnë të drejtën e kryerjes së procedurës së prokurimit një autoriteti tjetër kontraktor për shkak të kapaciteteve që ky i fundit ka në fushën e objektit të prokurimit.

Autoriteti kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta e prokurimit, është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e.”.

Neni 2

Shkronja “c”, e nenit 3, “Buletini i Njoftimeve Publike”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“c) lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në prokurimin publik nga koncesionet/partneriteti publik privat apo nga pjesëmarrja në ankandet publike, si dhe arsyet e këtij përjashtimi, në bazë të pikës 3, të nenit 13, të LPP-së.”.

Neni 3

Neni 4, “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik”, ndryshohet si më poshtë vijon:

¹ Ky projektvendim synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 2014/24/BE, datë 26 shkurt 2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për prokurimin publik, që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE-CELEX: 32014L0024.



“Neni 4

Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik

1. Në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti kontraktor është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrin vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së.

Ky regjistër duhet të përgatitet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga miratimi i ligjit për buxhetin.

Autoritetet kontraktore, brenda 5 (pesë) ditëve nga hartimi i regjistrin të parashikimit të procedurave të prokurimit, të dërgojnë në organin qendror blerës të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës për objektet që do të prokurohen në mënyrë të përqendruar.

Autoriteti kontraktor ka detyrimin të krijojë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem.

APP-ja nuk do të lejojë publikimin e regjistrave të parashikimeve, të cilët nuk janë hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik.

Një kopje e regjistrin të parashikimeve pas publikimit nga APP-ja duhet të dërgohet në degën e thesarit dhe në institucionin qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.

2. Çdo autoritet kontraktor, i cili do të luajë rolin e organit qendror blerës, dhe autoriteti, të cilit i është deleguar e drejta për prokurim (nëse është rasti), duhet të krijojë një regjistër parashikimi për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen prej tyre, menjëherë me mbledhjen e të dhënave, por, në çdo rast, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga marrja e tyre.

Organi qendror blerës dhe autoriteti, të cilit i është deleguar e drejta për prokurim (nëse është rasti), kanë detyrimin të krijojë/të modifikojnë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e punës e krijimit të tij në sistem.

3. Organet e pushtetit vendor, ndërmarrjet shtetërore apo çdo autoritet kontraktor tjetër jobuxhetor përgatitjen regjistrin e parashikimeve të

procedurave të prokurimit publik, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit apo planit të blerjeve nga këshillat vendorë ose nga organet drejtuese përkatëse.

Këto autoritete kontraktore kanë detyrimin të krijojnë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e krijimit të tij në sistem.

4. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste të justifikuara.

Çdo ndryshim i regjistrin të parashikimeve bëhet nga vetë autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i tij nga APP-ja të bëhet brenda tri ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem.

APP-ja nuk do të lejojë publikimin e ndryshimit të regjistrave të parashikimeve, nëse konstaton se ky ndryshim nuk është bërë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik.

Një kopje e këtyre ndryshimeve, pas publikimit të tyre nga APP-ja duhet t'u dërgohet degës së thesarit dhe institucionit qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.”

Neni 4

Në nenin 6, “Publikimi i njoftimit të fituesit, njoftimit të kontratës së lidhur dhe njoftimit të anulimit”, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1 me këtë përmbajtje:

“3.1. Në rastin e delegimit të prokurimit, autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e duhet të dërgojë/jnë njoftimin e kontratës së lidhur pranë autoritetit kontraktor, i cili ka zhvilluar procedurën e prokurimit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës. Ky i fundit dërgon për publikim në Buletin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga autoriteti kontraktor.”

2. Në pikën 6 bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fjalinë e parë, pas fjalëve “... hedhja në sistemin elektronik të njoftimit të fituesit, ...” shtohen “... njoftimi i anulimit ...”.



b) Në fjalinë e dytë, pas fjalëve “... shpallja e njoftimit të fituesit ...” shtohen “... njoftimi i anulimit ...”.

Neni 5

Neni 7, “Raporti i realizimeve të prokurimit publik”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 7

Realizimi i procedurave të prokurimit

1. Autoriteti kontraktor, në përfundim të çdo procedure prokurimi, pas lidhjes së kontratës e pasqyron këtë procedurë në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar në udhëzimet e APP-së.

2. Autoriteti kontraktor, çdo katër muaj, por jo më vonë se datat 10 maj, 10 shtator dhe 10 janar të çdo viti, dorëzon në organet qendrore, që vënë në dispozicion fondet, një informacion të hollësishëm për procedurat e prokurimit të realizuara.

3. Çdo katër muaj, APP-ja duhet të dorëzojë në Këshillin e Ministrave një përmbledhje të procedurave të prokurimeve të realizuara në shkallë kombëtare.

4. Autoriteti kontraktor, në fillim të çdo viti, përgatit një regjister të procedurave të prokurimit të kryera gjatë vitit paraardhës, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar nga APP-ja. Një kopje e regjistrin u dorëzohet organeve qendrore, që vënë në dispozicion fonde, jo më vonë se data 15 janar.

APP-ja publikon regjistrin kombëtar të procedurave të prokurimit publik të realizuara për vitin paraardhës, brenda datës 20 janar.

5. Çdo organ qendror blerës, në përfundim të çdo procedure prokurimi, pas lidhjes së kontratës e pasqyron këtë procedurë në regjistrin e procedurave të prokurimit të realizuara, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar në udhëzimet e APP-së.”.

Neni 6

Pikat 2 dhe 3, të nenit 8, “Kufijtë monetarë”, ndryshohen si më poshtë vijon:

“2. Për prokurimet, vlera e përlogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, është nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 800 000 (tetëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë

procedurën për prokurim me vlerë të vogël, siç përkrahëhet në nenin 40 të këtyre rregullave.

Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit.

Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik.

Pagesat për këto objekte bëhen sipas legjislacionit tatumor në fuqi dhe faturat e lëshuara në këto raste kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë.

3. Për veprimtari të përcaktuara në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, si dhe për artikuj dhe shërbime protokollare që i shërbejnë veprimtarisë së përditshme të autoriteteve kontraktore, sipas legjislacionit në fuqi, vlera e përlogaritur e prokurimeve me vlerë të vogël për artikuj apo grup-artikujsh brenda një viti kalendarik është nën vlerën e kufirit të ulët monetar.”.

Neni 7

Në pikën 2, të nenit 11, “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit”, pas fjalëve “... formularin për deklarimin e konfliktit të interesit...” shtohen “... formulari i informacionit konfidencial: ...”, si dhe pas fjalëve “... njoftimin e kontratës së lidhur ...” shtohen “... njoftim i anulimit të procedurës ...”.

Neni 8

Në fund të nenit 12, “Njoftimi i kontratës”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në rastet e procedurave të prokurimit të rishpallura pas anulimit, njoftimi i kontratës duhet të përmbajë të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar, si numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik, objekti dhe fondi limit.”.

Neni 9

Në nenin 14, “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët” bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Fjalja e parë, e pikës 2, ndryshohet si më poshtë vijon:



“Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.”

2. Fjalja e parë, e pikës 3, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në udhëzime duhet të përcaktohet që, nëse autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme një vizitë në terren/objekt, atëherë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në tender duhet të kenë mundësi të barabarta për të vëzhguar terrenin e punës/ekzekutimit.”

3. Paragrafi i dytë, i pikës 6, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.”

4. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën pesë ditë përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshmërinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë ofertuesit, me shkrim, të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton autoritetin kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së autoritetit kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë autoriteti kontraktor do të refuzojë ofertën.

Nëse procedura e prokurimit është e pezulluar, koha e pezullimit nuk llogaritet në periudhën e vlefshmërisë së ofertës.”

Neni 10

Neni 15, “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 15

Përmbushja e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit.

Në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e këtij deklarimi, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme.”

Neni 11

Në nenin 16, “Deklarimi i konfliktit të interesit”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe zëvendësohet me “Deklarimi i konfliktit të interesit dhe informacioni konfidencial”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 2, me këtë përmbajtje:

“2. Nëpërmjet listës së informacionit konfidencial, kandidati/ofertuesi deklaron informacionin që kërkon të mbahet konfidencial.”

Neni 12

Në pikën 1, të nenit 18, “Sigurimi i ofertës”, shtohet një fjalë, me këtë përmbajtje:

“Sigurimi i ofertës nuk kërkohet në procedurat e prokurimit me vlerë më të ulët se kufiri i lartë monetar.”

Neni 13

Pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/1

Njoftimi i anulimit

1. Autoriteti kontraktor dërgon për publikim njoftimin e anulimit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të anulimit.

2. Njoftimi duhet të përmbajë:

- numrin e referencës së procedurës dhe emrin e autoritetit kontraktor;
- përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve;



- arsyet e anulimit të procedurës sipas përcaktimeve të nenit 24, të LPP-së.”.

Neni 14

Në nenin 26, “Kontratat për punë publike”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “b”, e pikës 7, ndryshohet si më poshtë vijon:

“b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 50 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose.”.

2. Në pikën 8 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës “c” shtohen shkronjat “ç” dhe “d”, me këtë përmbajtje:

“ç) Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që nuk është fitues dhe/apo ka në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t’u lidhur, sipas LPP-së, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës.

Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve, ku secili prej tyre, për t’u kualifikuar për punë publike, duhet të ketë përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës, që ai ka marrë përsipër të realizojë në përputhje me kontratën e bashkëpunimit.

Ky kusht nuk do të zbatohet nëse operatorët ekonomikë janë kontraktorë/nëkontraktorë në një investim/investime dhe nuk i kanë përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës, për shkaqe të përligjura, si vijon:

i) vonesa si pasojë e ndërthurjes me një vepër tjetër në ndërtim, si: KUZ, OSHEE etj.;

ii) dëmtimi apo dalja në dritë e objekteve me vlera historike;

iii) vonesa në shpronësimin e subjekteve, të cilave u përket prona;

iv) ndryshim në prioritetet e qeverisjes në financim;

v) rishpërndarje të fondeve si pasojë e ndonjë emergjence, të justifikuara nga autoriteti kontraktor,

sipas dokumentacionit të lëshuar nga ky i fundit.

Në çdo rast, një vërtetim i tillë nuk do të lëshohet për subjektet nëse, sipas grafikut të punimeve, pjesë e kontratës, deri në periudhën në fjalë, ato nuk do të mund të kishin kryer më shumë se 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës.

d) Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100% i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.”.

3. Pika 10 shfuqizohet.

Neni 15

Shkronja “b”, e pikës 5, të nenit 27, “Kontratat e mallrave”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose.”.

Neni 16

Në nenin 28, “Kontratat e shërbimeve”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas paragrafit të tretë, të pikës 3, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”.

b) Shkronja “b”, e pikës 4, ndryshohet si më poshtë vijon:

“b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga



autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose.”.

c) Pas shkronjës “ç”, të pikës 5, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

Neni 17

Në nenin 29, “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.”.

Neni 18

Pika 1, e nenit 30, “Kërkesat e cilësisë”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”.

Neni 19

Në shkronjën “b”, të pikës 3, të nenit 31, “Kriteret për vlerësimin e ofertës”, pas fjalëve “... taksë karboni ...” shtohen “..., si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi ...”.

Neni 20

Shkronja “a”, e pikës 2, të nenit 35, “Procedura me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) Kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme mbi ose nën kufirin e ulët monetar janë dorëzuar vetëm oferta të pavlefshme. Oferta vlerësohet e pavlefshme nëse nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në

dokumentet e tenderit. Në çdo rast, pavlefshmëria e ofertave nuk duhet të vijë si shkak i gabimeve të bëra në dokumentet e tenderit dhe/ose për shkak të ndonjë veprimi të autoritetit kontraktor.

Kushtet e kontratës dhe kriteret e veçanta të pranimit, që nuk lidhen përpjesëtimisht me fondin limit, nuk duhet të ndryshojnë nga ato të procedurës së fundit të anuluar.”.

Neni 21

1. Në nenin 36, “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Fjalja e dytë e shkronjës “c” ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në këtë rast, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme.”.

ii) Në shkronjën “dh”, fjalët “... kur zgjaten kontratat ...” zëvendësohen me “... për kontratat ...”.

iii) Në shkronjën “e”, fjalët “... procedurën e hapur ose të kufizuar ...” zëvendësohen me “... procedurën mbi ose nën kufirin e ulët monetar ...”.

iv) Shkronja “ë” shfuqizohet.

2. Në fund të pikës 5 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në rastin kur autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake sipas parashikimeve të pikës 2, shkronjat “d”, “dh” dhe “e”, të këtij neni, kur kontraktori i fundit është bashkim operatorësh ekonomikë, autoriteti kontraktor duhet të sigurohet që ky bashkim është i vlefshëm nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarimi nga anëtarët e këtij bashkimi.”.

Neni 22

Në nenin 37, “Shërbimet e konsulencës”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në rastin e bashkimit të konsulentëve secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme të pranimit, ndërkohë kriteret e veçanta të pranimit plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Autoriteti kontraktor, përveç kriterëve të përcaktuara në LPP, për skualifikimin e kandidatëve ose të ofertuesve duhet të vlerësojë edhe mbi kushtet e konfliktit të interesit, si vijon:



a) Konfliktin ndërmjet konsulentëve. Konsulentët nuk mund të ofertojnë me të njëjtën përbërje të stafit. Për këtë qëllim, anëtarët e stafit të një konsulenti duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e tyre për konsulentin dhe mosangazhimin në konsulentë të tjerë ofertues në të njëjtën procedurë.

b) Konfliktin ndërmjet veprimtarive të konsulencës dhe prokurimit të mallrave, punëve ose shërbimeve. Në këtë rast, operatori ekonomik i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për mallra, punë ose shërbime për një projekt dhe secili prej anëtarëve të tij duhet të skualifikohet nga ofrimi i shërbimeve të konsulencës që lidhen me këto mallra, punë ose shërbime. Nga ana tjetër, konsulenti i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për përgatitjen ose zbatimin e një projekti dhe secili prej anëtarëve të tij duhet të skualifikohen nga furnizimi i mallrave, kryerja e punëve ose shërbimeve (me përjashtim të shërbimeve të konsulencës) që rrjedhin ose janë të lidhura drejtpërdrejt me shërbimet e konsulencës për këtë përgatitje ose zbatim.

c) Konfliktin ndërmjet detyrave të konsulencës. As konsulentët dhe as ndonjëri prej anëtarëve të stafit të tyre nuk duhet të punësohen për kryerjen e ndonjë detyre që për nga natyra e saj mund të jetë në konflikt me një detyrë tjetër të konsulentëve.

ç) Marrëdhënien me stafin e autoritetit kontraktor: konsulentët (përfshirë stafin e tyre dhe nënkonsulentët) nuk duhet të kenë marrëdhënie biznesi ose familjare me një anëtar të stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejt ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.”.

3. Në pikën 4 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë vijon:

“b) Titullari i autoritetit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit, me të njëjtën përmbajtje, siç përcaktohet në nenin 60 të këtyre rregullave.

Titullari i autoritetit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhrin për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, siç përcaktohet në nenin 58 të këtyre rregullave. Në rastin e shërbimit të konsulencës, të gjithë anëtarët e komisionit duhet të jenë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet.”.

b) Në nënndarjen e dytë, të shkronjës “d”, fjalët “... me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar ...” zëvendësohen me “... me vlerë nën kufirin e lartë monetar ...”.

c) Në shkronjën “ë”, paragrafi i dytë, nënndarja e dytë, fjalët “... me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar ...” zëvendësohen me “... me vlerë nën kufirin e lartë monetar ...”.

4. Në shkronjën “ë”, nënndarja “ii”, pas fjalëve “... transferimin e njohurive, nëse kërkohet ...” shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Nëse nuk kërkohet, pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t’i shtohen kriterit “kualifikimet e stafit kryesor të propozuar.”.

5. Në paragrafin e pestë, të shkronjës “ë”, pas fjalisë “Ky proces regjistrohet nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim”, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Secili prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të shpjegojë në detaje vlerësimin e tij.”.

Neni 23

Në nenin 40, “Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël” bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e dytë, të pikës 1, hiqen fjalët “... në fillim të vitit ...”.

2. Fjalia e dytë, e pikës 2, hiqet.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre.

Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës duhet të përllogaritë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 59 të këtyre rregullave, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme.

Urdhri i prokurimit duhet të shoqërohet me ftesën për ofertë, që u drejtohet operatorëve ekonomikë, në të cilën përcaktohen të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit.”.



4. Pika 4 shfuqizohet.

5. Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Në rastin kur procedura e prokurimit me vlerë të vogël kryhet me mjete elektronike, anëtarët e komisionit ftojnë të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë, kur është e mundur, si dhe publikojnë ftesën për ofertë për çdo të interesuar, në sistemin e prokurimit elektronik.

Në çdo rast, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet autoritetit kontraktor, brenda afatit të përcaktuar nga ky i fundit në ftesën për ofertë.

Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet të njoftojë autoritetin kontraktor brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë. Në njoftim duhet të jepen arsyet, që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit. Autoriteti kontraktor mund të refuzojë ofertën e paraqitur nga një operator ekonomik, i cili në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël, të zhvilluar nga ky autoritet gjatë këtij viti, nuk e ka njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë mbi arsyet që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.

Kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë.

Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nëpërmjet një procesverbali të mbajtur për këtë qëllim. Në çdo rast, autoriteti kontraktor të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm operatorët ekonomikë të renditur deri në vendin e dhjetë të klasifikimit.

Afati i fundit për pranimin dhe hapjen e ofertave nuk duhet të jetë ditë pushimi (e shtunë, e diel, festa zyrtare).

Duke qenë se procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë procedura të thjeshtuara, për këto procedura nuk zbatohen përcaktimet e nenit 56, të LPP-së, për ofertat anomalisht të ulëta dhe përcaktimet e nenit 63, të LPP-së, për ankimin administrativ.

Kryerja e procedurës me mjete elektronike të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.”.

6. Fjala e parë, e pikës 6, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për blerjen e mallrave, për të cilat ka një nevojë emergjente apo për kryerjen e shërbimeve të paparashikueshme me kusht që vlera e përllogaritur e mallrave dhe shërbimeve nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë.”.

Neni 24

Pas nenit 40 shtohet neni 40/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 40/1

Sistemi dinamik i blerjes

Sistemi dinamik i blerjes është një sistem tërësisht elektronik që mund të përdoret për blerje të përsëritura. Ky sistem është i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë, që regjistrohen në sistemin e prokurimit elektronik dhe operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet.

Autoriteti kontraktor përdor sistem të thjeshtuar të blerjes dinamike për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, në përputhje me udhëzimet e APP-së.”.

Neni 25

Pas shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 42, “Marrëveshja kuadër”, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) një autoriteti kontraktor dhe një operatori ekonomik.”.

Neni 26

Neni 43, “Qëllimi”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 43

Një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur dhe/ose kur është e vështirë ose e pamundur për të përcaktuar paraprakisht volumet që duhet të prokurohen dhe nuk ka siguri për kohën e dorëzimeve/realizimeve e të ekzekutimit të kontratave.

Ndryshimi ndërmjet një marrëveshjeje kuadër dhe kontratave të tjera që lidhen sipas procedurave të prokurimit të parashikuara në LPP është se kushtet e mallrave/shërbimeve/punëve, që do të



prokurohen, nuk janë të përcaktuara në një marrëveshje kuadër. Autoritetet kontraktore mund të blejnë vetëm për të plotësuar nevojat e tyre dhe jo për nevoja të autoriteteve kontraktore që nuk janë pjesë në marrëveshjen kuadër.”.

Neni 27

Pika 2, e nenit 45, “Prokurimi i marrëveshjes kuadër”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 55, të LPP-së. Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi.”.

Neni 28

Pas nenit 45 shtohet neni 45/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 45/1

Përlllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër

1. Vlera e parashikuar e një marrëveshjeje kuadër duhet të përfshijë shumën e përlllogaritur të të gjitha vlerave të kontratave që parashikohen të jepen gjatë kohës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

2. Në rastin kur autoriteti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e objektit të prokurimit, për efekt të përlllogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër duhet t’u referohet, për aq sa është e mundur, nevojave të planifikuara dhe/ose nevojave të mëparshme për këtë objekt. Në çdo rast, përlllogaritja e nevojave duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të papërfshira në marrëveshjen kuadër.”.

Neni 29

Pas paragrafit të pestë, të pikës 4, të nenit 47, “Llojet e marrëveshjes kuadër”, shtohen dy paragrafë, me këtë përmbajtje:

“Forma e komunikimit përzgjidhet nga autoriteti kontraktor, në varësi të kohës në dispozicion për përmbushjen e nevojës. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për të ruajtur konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertave, deri në vlerësimin përfundimtar të tyre.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet t’u dërgojë, në të njëjtën kohë, ftesën për ofertë të gjithë operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër.”.

Neni 30

Pas nenit 47 shtohen nenet 47/1 dhe 47/2, me këtë përmbajtje:

“Neni 47/1

Dhënia e kontratave sipas marrëveshjes kuadër

1. Kontratat mund të jepen mbi bazën e marrëveshjes kuadër përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së saj. Periudha e vlefshmërisë së kontratave të lidhura mbi bazën e një marrëveshjeje kuadër mund të kalojë periudhën e vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

2. Në rastin e marrëveshjes kuadër ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, gjatë rihapjes së konkurrimit autoriteti kontraktor është i detyruar të krijojë një komision vlerësimi për dhënien e një kontrate në bazë të marrëveshjes kuadër.

Nuk është e nevojshme që përbërja e komisionit të jetë e njëjtë me atë të komisionit të vlerësimit të ofertave, të përcaktuar për kryerjen e procedurës së prokurimit për marrëveshjen kuadër.

3. Dhënia e kontratave në bazë të një marrëveshjeje kuadër të realizuar nga një autoritet kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës do të bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese.

3.1 Në rastin e marrëveshjeje kuadër, të realizuara nga një autoritet kontraktor, njoftimi i kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik do të dërgohet për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike, në Agjencinë e Prokurimit Publik, nga autoriteti kontraktor. Ky njoftim do të dërgohet në formë të shkruar dhe elektronike (CD), jo më vonë se data 10 janar e vitit në vijim.

3.2 Në rastin e marrëveshjeje kuadër, të realizuara nga një autoritet kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës, njoftimi i kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik do të dërgohet për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike, në Agjencinë e Prokurimit Publik nga autoriteti kontraktor, në cilësinë e organit qendror blerës. Ky njoftim do të dërgohet në formë të shkruar dhe elektronike (CD), jo më vonë se data 10 janar e vitit në vijim.



4. Sasitë e parashikuara janë vetëm “sasi orientuese”. Autoriteti kontraktor mund të blejë më pak ose më shumë se sasitë e parashikuara (por në çdo rast brenda vlerës së përlogaritur të marrëveshjes kuadër).

5. Operatori ekonomik, që është palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të formojë një bashkim operatorësh ekonomikë dhe të paraqesë ofertë për një kontratë, pasi është bërë palë e kësaj marrëveshjeje kuadër.

6. Operatori ekonomik, që është palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të caktohet si nënkontraktor i një operatori ekonomik tjetër, që i është dhënë kontrata sipas së njëjtës marrëveshjeje kuadër.

7. Nëse një operator ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër, nuk përmbush më kriteret e kualifikimit, për të cilat është shpallur fitues në këtë marrëveshje, është i detyruar të njoftojë autoritetin kontraktor menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga momenti i ndodhjes së një ndryshimi të tillë.

Në rast se autoriteti kontraktor konstaton mospërmbushjen e këtij detyrimi, duhet të veprojë në përputhje me nenin 47, të LPP-së.”

Neni 47/2

Ndryshimi në numër i palëve të marrëveshjes kuadër

Nëse para mbarimit të marrëveshjes kuadër, të nënshkruar me disa operatorë ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, mbetet vetëm një operator ekonomik, autoriteti kontraktor nuk duhet të japë kontrata sipas kësaj marrëveshjeje kuadër.

Kur lind një situatë e tillë, autoriteti kontraktor është i detyruar të njoftojë menjëherë operatorin ekonomik të mbetur në marrëveshjen kuadër. Vlefshmëria dhe efektiviteti i marrëveshjes kuadër pushojnë së ekzistuari me këtë njoftim.

Në rast se një operator ekonomik nuk i përgjigjet dy herë radhazi ftesës së autoritetit kontraktor gjatë rihapjes së konkurrimit, ky operator nuk do të jetë më palë e marrëveshjes kuadër.”

Neni 31

Në paragrafin e dytë, të nenit 56, “Titullari i autoritetit kontraktor”, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së

cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.”

Neni 32

Neni 57 “Njësia e prokurimit” ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 57

Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit

1. Titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/ personat përgjegjës për prokurimin dhe dërgon emrin/emrat respektivë në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Personi/at përgjegjës për prokurimin duhet të administrojë/jnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit.

Në varësi të numrit të procedurave të prokurimit të parashikuara për t’u zhvilluar, autoriteti kontraktor mund të caktojë më shumë se një person përgjegjës për prokurimin.

2. Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit kontraktor krijon njësinë e prokurimit, në përbërje të së cilës është personi përgjegjës për prokurimin, i caktuar në fillim të vitit dhe të paktën një specialist fushe në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit. Në raste të tjera, titullari i autoritetit kontraktor cakton në përbërjen e njësive të prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë.

Në rast mungese personeli, autoriteti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm.

Përveç sa më sipër, autoriteti kontraktor mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete kontraktore.

3. Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme:

- Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;

- Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme;

- Hartimin e urdhrit të prokurimit;



- Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;

- Hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;

- Hartimin dhe dërgimin e ftesave për pjesëmarrje kandidatëve të ftuar në një procedurë prokurimi, duke argumentuar përzgjedhjen e tyre;

- Administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;

- Llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti;

- Në kuadër të hartimit të dokumenteve të tenderit, bashkërendimin e punës me APP-në, me qëllim realizimin e kësaj detyre me efikasitetin dhe në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi;

- Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor;

- Administrimin e sigurimit të kontratës përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor;

- Përcjelljen pranë APP-së të raportimeve mbi ecurinë e zbatimit të kontratës, në rastet kur kërkohet, si dhe të raportimit përfundimtar të ekzekutimit të kontratës.

4. Specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, kryen detyrat e mëposhtme:

- Hartimin e specifikimeve teknike, në rast se nuk janë hartuar nga struktura të tjera;

- Përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;

- Hartimin e kritereve të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik;

- Hartimin e kritereve të vlerësimit, nëse është rasti;

- Përcaktimin e çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh., grafiku i livrimit).

Në rast se detyrat e sipërpërmendura nuk janë hartuar nga struktura të posaçme, si më sipër, ato do të kryhen nga njësia e prokurimit për objektin që prokurohet.”

Neni 33

Në paragrafin e parë, të nenit 58, “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë vijon:

“Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës.”.

Neni 34

Në pikën 2, të nenit 59, “Përlllogaritja e vlerësimit të kontratës”, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “ç”, fjalët “... të botuara ...” zëvendësohen me “... të shpallura publikisht ...”.

2. Fjalia e fundit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerësimit të kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.”.

Neni 35

Neni 60, “Urdhri i prokurimit”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 60

Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përlllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të kësaj rregullore, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;

- fondin e përlllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përlllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;

- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);

- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit.”.

Neni 36

Pikat 2 dhe 3, të nenit 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, ndryshohen si më poshtë vijon:

“2. Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse



është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjrisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga njësia e prokurimit.

Nëse gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, përpara publikimit të një procedure prokurimi, njësia e prokurimit ka nevojë për asistencë, komunikon me APP-në për të marrë një mendim të specializuar.

Me qëllim dhënien e asistencës, ngritjen e kapaciteteve dhe sigurimin e mirëmbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, APP-ja në koordinim me personin/at përgjegjës për prokurimin mund të asistojë këto të fundit gjatë përgatitjes të dokumenteve të tenderit në përputhje me dokumentet standard të tenderit dhe rregullat e prokurimit publik.

Për efekt shpejtësie, komunikimi me APP-në për koordinimin e veprimtarisë gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit dhe marrjes së asistencës mund të bëhet me mjete elektronike (me *e-mail*).

Afatet dhe procedura e detajuar e koordinimit të veprimtarisë së njësive të prokurimit me APP-në në funksion të marrjes së asistencës dhe ngritjes së kapaciteteve rregullohen me udhëzim të APP-së.

3. Pas nënshkrimit të njoftimit të kontratës nga titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar, personi/at përgjegjës për prokurimin dërgon/jnë dokumentet e tenderit për publikim, në përputhje me nenet 38 e 39 të LPP-së.”

Neni 37

Fjala e parë, e nenit 65, “Ndërhyrja në ofertë”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën procedurë prokurimi.”

Neni 38

Në nenin 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Faqe | 13128

1. Në fjalinë e parë, të pikës 2, pas fjalës “... procedurës ...” shtohen fjalët “... së vlerësimit ...”.

2. Në pikën 4, paragrafi i parë, nënndarja e dytë, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë vijon:

“Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.”.

3. Në pikën 8 shtohet një fjali, me këtë përmbajtje:

“Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim.”.

Neni 39

Neni 68, “Raporti përmbledhës”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 68

Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor.

Raporti përmbledhës duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; ofertuesin e renditur të parin; informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave.”.

Neni 40

Neni 73, “Mungesa e konkurrencës”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 73

1. Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në një procedurë prokurimi, duhet të pranohet të paktën 1 (një) ofertë e vlefshme. Në të kundërt, autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit.

2. Autoriteti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që shkaktojnë dështimin e procedurës dhe, nëse është rasti, i



korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës. Ky proces dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim nga njësia e prokurimit.”.

Neni 41

Në nenin 76, “Kohëzgjatja e kontratës”, bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e parë, të pikës 1, fjalët “... kontrata shtesë, në përputhje me shkronjën “b”, të pikave 3 e 5, të nenit 33, të LPP-së ...” zëvendësohen me “... kontrata shumëvjeçare ...”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Autoritetet kontraktore, për plotësimin e nevojave me mallra dhe shërbime të vazhdueshme, në fillim të çdo viti, lejohen të zgjasin afatin e kontratës së fundit të lidhur pas përfundimit të një procedure konkurruese, nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate shtesë me të njëjtin kontraktues, deri sa të kryhen procedurat e prokurimit. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë në mënyrë të detajuar nevojën për zgjatjen e kontratës.

Kontrata shtesë për mallrat apo shërbimet e vazhdueshme mund të bëhet deri në një vlerë maksimumi 20% të kontratës së fundit të lidhur pas përfundimit të një procedure konkurruese dhe fondet për këtë kontratë do të përballohen nga fondet e vëna në dispozicion të autoritetit kontraktor në buxhetin e atij viti.

Në çdo rast, edhe pse nuk realizohen me procedurë prokurimi, planifikimi dhe realizimi i këtyre kontratave shtesë me vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen në regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të procedurave të prokurimit publik.”.

Neni 42

Në nenin 77, “Mbikëqyrja e kontratës”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, (nëse është rasti) mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin në fuqi.”.

2. Në fjalinë e dytë, të pikës 2, fjalët “... përfundimi i saj ...” zëvendësohen me “... përfundimi i afatit të zbatimit të saj ...”.

3. Fjalja e dytë, e pikës 3, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Autoriteti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.”.

4. Pikat 4, 5 dhe 6 ndryshohen si më poshtë vijon:

“4. Personi/at përgjegjës për prokurimin merr/marrin informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi ecurinë e zbatimit të kontratës dhe në rast të konstatimit të problematikave në këtë proces, ia raporton/raportojnë APP-së.

Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Një kopje e këtij raporti i dërgohet APP-së, si dhe mund t'i vihet në dispozicion kontraktorit, me kërkesë të tij, nga personi/at përgjegjës për prokurimin.

5. Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, sipas *Reuters*, ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës sipas *Reuters*, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.

6. Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, sipas *Reuters*, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shitjes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të livruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori.”.

Neni 43

Në fjalinë e parë të shkronjës “a”, të pikës 6, të nenit 78, “Ankesat në autoritetin kontraktor”, pas fjalëve “... nga 3 (tre) persona ...” shtohen “... ku të paktën njëri është ekspert i fushës ...” dhe në fjalinë e dytë pas fjalëve “... 1 (një) zyrtari të vetëm ...” shtohen “... i cili duhet të jetë ekspert fushe ...”.



Neni 44

Pas pikës 4, të nenit 79, “Sanksionet administrative”, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Autoriteti kontraktor përkatës ka detyrimin të informojë Agjencinë e Prokurimit Publik për zbatimin e masave të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, brenda afatit kohor të përcaktuar prej saj.”.

Neni 45

Pas pikës 2, të nenit 81, “Masat disiplinore”, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Autoriteti kontraktor përkatës ka detyrimin të informojë Agjencinë e Prokurimit Publik për zbatimin e masave të vendosura sipas pikës 1 të këtij neni, brenda afatit kohor të përcaktuar prej saj.”.

Neni 46

Dispozita tranzitore

Procedurat e prokurimit të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi të vazhdojnë sipas rregullave të prokurimit publik, në bazë të të cilave ato janë shpallur.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 809, datë 29.12.2017

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT
TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT, DATË 3.12.2015,
PËR ÇËSHTJEN “BICI KUNDËR
SHQIPËRISË” (PËR ANKIMIN
NR. 5250/07)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

Faqe | 13130

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 3.12.2015, bërë përfundimtar në datën 3.3.2016, për çështjen “Bici kundër Shqipërisë” (ankimi nr. 5250/07), në shumën 7 850 (shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) euro, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të aplikantit z. Xhaferr Bici, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 3.12.2015, për çështjen “Bici kundër Shqipërisë” (ankimi nr. 5250/07), bërë përfundimtar në datën 3.3.2016.

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të z. Xhaferr Bici, të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i Gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit tremujor të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 811, datë 29.12.2017**

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT
2018 PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 13, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të nenit 29, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit të shërbimit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin


2018, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e buxhetit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin 2018, sipas shtojcave 2 e 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2018.

KRYEMINISTRI
Edi Rama





SHTOJCA 2

Në 000/ lekë

BUXHETI 2018

Përshkrimi	Buxheti 2018	
	Të ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Të ardhura nga shërbimet	2,615,220	
Shpenzime personeli		815,604
Shpenzime korente		306,413
Investime		868,440
Fonde te lira për t'u shpërndarë gjatë vitit		520,063
Fondi rezervë		104,700
TOTAL	2,615,220	2,615,220
TEPRICA (1)-(2)		0

SHTOJCA 3

BUXHETI I VITIT 2018

Në 000/ lekë

Nr.	Emërtimi	Buxheti 2018
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	2,615,220
	Të ardhura nga tarifat e shërbimeve	1,634,458
	Fonde që parashikohet të trashëgohen nga viti 2017	876,061
	Fond rezervë i trashëguar	104,700
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	2,615,220
1	Shpenzime personeli	815,604
	Paga	674,079
	Kontribute për sigurime shoqërore	111,895
	Fondi i veçantë i pagave	29,630
2	Shpenzime operative	306,413
	Shpenzime të mirëmbajtjes e të tjera	306,413
3	Shpenzime kapitale	1,388,503
	Investime kapitale të brendshme	868,440
	Fonde të lira për t'u shpërndarë gjatë vitit	520,063
4	Fondi rezervë	104,700
	Fondi rezervë	104,700
	TE ARDHURA (-) SHPENZIME	0

**VENDIM**

Nr. 812, datë 29.12.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 245, DATË 29.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN ME QIRA, ME TARIFË TË REDUKTUAR, TË SALLËS SË KONCERTEVE TË PALLATIT TË KONGRESEVE, TEATRIT KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 8, të kreut III, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës së mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 245, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, viti “2017” zëvendësohet me “2018”.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 813, datë 29.12.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 618, DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pikat 1 dhe 2, e 20, pika 3, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në përmbajtjen e vendimit:

- fjalët “... kurse kualifikimi ...” zëvendësohen me “... kurse të formimit profesional ...”;

- fjalët “... arsim i lartë apo studime pasuniversitare ...” zëvendësohen me “... arsim i lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë ...”;

- fjala “... komunë ...” zëvendësohet me “... njësi administrative ...”;

- Emërtimi “Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” zëvendësohet me “Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.

2. Pikat 6 dhe 7, të kreut I, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“6. Personat me aftësi të kufizuara, të përcaktuar në pikat 1 e 2, të këtij vendimi, pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Kriteret e dhënies së dëshmisë dhe forma e saj përcaktohen në rregulloren e Shërbimit Social Shtetëror.

7. Kriteret mjekësore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe veprimtaria e komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, të përcaktuar në pikat 1 e 2, të këtij vendimi, përcaktohen në rregulloren e miratuar me urdhër



të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.”.

3. Në kreun II bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 12, fjalët “... kohëzgjatja normale e ciklit shkollor ...” zëvendësohen me “... kohëzgjatja normale e programit të studimit ...”.

b) Në pikën 18, fjalët “... u lind e drejta e përfitimit të pagesës dy muaj pas marrjes së vendimit nga ky komision ...” zëvendësohen me “... u lind e drejta e përfitimit të pagesës në muajin pasardhës nga data e marrjes së vendimit nga ky komision ...”.

4. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 19 ndryshohet si më poshtë vijon:

“19. Personat që komisionohen për aftësinë e kufizuar pajisen nga institucioni shëndetësor i specializuar me shtretër (spitali) me fletën e drejtimit për në KMCAP. Personat që rikomisionohen për aftësinë e kufizuar pajisen nga mjeku specialist me epikrizë në bazë të rekomandimit të mjekut të familjes. Dokumentacioni për komisionimin/rikomisionimin e aftësisë së kufizuar së bashku me kopje të dokumentit të identifikimit dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve nga institucioni shëndetësor pranë njësisë administrative ku individi ka vendbanimin.”.

b) Në pikën 20, pas fjalëve “... duhet të paraqesë ...” shtohen “... pranë administratorit shoqëror, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ...”.

c) Në pikën 21, pas fjalëve “... duhet të paraqesin ...” shtohen “... për çdo fillim të vitit akademik ...”.

ç) Pika 23 shfuqizohet.

d) Pika 24 ndryshohet si më poshtë vijon:

“24. Administratori shoqëror, me marrjen e dokumentacionit nga institucioni shëndetësor e dërgon atë brenda 24 (njëzet e katër) orëve, me procesverbal pranë mjekut të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe listën emërore të personave që do të vlerësohen apo do të rivlerësohen pranë KMCAP-së. Mjeku verifikon nëse dosjet e paraqitura janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës dhe, më pas, i përcjell ato në KMCAP. Mjeku mban regjistrin e personave me aftësi të kufizuara, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.”.

dh) Pas pikës 24 shtohet pika 24/1, me këtë përmbajtje:

“24/1. Personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë në marrëdhënie pune, u ndërpritet pagesa e aftësisë së kufizuar e përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi. Ndërprerja e pagesës së aftësisë së kufizuar bëhet sipas përcaktimeve në pikën 2, të nenit 11, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, pasi të jetë kryer nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror verifikimi me bazën e të dhënave shtetërore të tatimeve. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror njofton administratorin shoqëror të njësisë administrative ku ka vendbanimin personi me aftësi të kufizuar për ndërprerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar apo vazhdimin e saj kur individit i ndërpritet marrëdhëniet e punës. Pagesat e tjera për shkak të aftësisë së kufizuar, që burojnë nga legjislacioni në fuqi, nuk ndërpritet për shkak të punësimit.”.

e) Pika 25 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“25. Në rastet e rikomisionimit administratori shoqëror njofton dy muaj para përfundimit të afatit të komisionimit personin për pajisjen me epikrizën përcjellëse.”.

ë) Pas pikës 25 shtohen pikat 25/1 dhe 25/2, me këtë përmbajtje:

“25/1. Personat, të cilëve iu ndryshon gjendja shëndetësore brenda afatit të përfitimit, i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit me fletëdrejtimi të re.

25/2. Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, në përfundim të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, për personat aplikues hedhin brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e komisionimit/rikomisionimit në arkivin elektronik dokumentacionin që përmban dosja e përfituesit dhe e dërgojnë atë pranë njësisë administrative të shoqëruar me njoftimin për vendimin për çdo person.”.

f) Pika 28 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“28. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 814, datë 29.12.2017**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 61,
DATË 3.2.2017, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
PAKETAVE TË PAJISJEVE MJEKËSORE
TË RIMBURSUESHME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 61, datë 3.2.2017, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1. Përfshihet, lista e pajisjeve mjekësore që do të rimburohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për vitin 2018, për pacientët e grup-moshës 0–18 vjeç, është sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Ngarkohet Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama****SHTOJCA NR. 1****LISTA E PAJISJEVE MJEKËSORE TË RIMBURSUESHME QË TREGTOHEN NË FARMACITË E SPITALEVE**

Nr.	Emri i pajisjes	Emërtimi i pajisjes sipas regjistrat të AKBPM-së	Njësia	Importuesi	Prodhuesi	Çmimi i tregtimit me shumicë/njësi në lekë, me TVSH	Çmimi i pacientit	Rimbursimi
1/1	Fisha Diabeti	Smart Chek II Blood Glucose Meter Set 1000300039; Smart Chek II Blood Test Strips 200020091	Fishë	Euromed	Major Biosystem Corp. 7F.,No.186, Jian-Yi RD., Jung-He District 285 New Taipei City Taiwan	20	0	20
1/2	Fisha Diabeti	Aparat eBsensor ;Fishe eBsensor	Fishë	Capo-Ap	Visgenër Inc. No.335, Sec.6, Zhonghua Rd. 30094 Hsinchu City Taiëan	27	7	20
1/3	Fisha Diabeti	Aparat dhe fisha glicemie Açuchek active Açuchek-Active Model GB mg/dl kit 07133767; Açuchek-Active Model 07124112	Fishë	Koslabor-Alb	Roche Diagnostics GmbH Sandhofer Str.116 68305 Mannheim Germany	28	8	20
1/4	Fisha	Blood Glucose measuring	Fishë	Net	Acon Laboratories,	32	12	20



	Diabeti	systems 23913; 23916		electronics	Inc. 10125 Mesa Rim Road San Diego CA 92121 USA			
1/5	Fisha Diabeti	Blood Glucose/Blood Glucose Meter Test Strips Contour Plus/84578240/ 84581926	Fishë	Trimed	Ascensia Diabetes Care Holdings AG Peter Merian- Strasse 90, 4052 Basel Switzerland	40	20	20
1/6	Fisha Diabeti	OTSelectPlus Strip 1x50; OTSelect Strip 1x 50; OTUltra Strip 50; OTSelectPlusFle x System; OTSelectPlus System	Fishë	Megastore	Lifescan Europe, A Div. of Cilag GmbH International Gubelstrasse 34 6300 Zug Switzerland	40	20	20

* Kompanitë importuese kanë deklaruar dhënien falas të aparateve për matjen e glicemisë, si edhe gjilpërave shpuese (1 në ditë).

VENDIM

Nr. 815, datë 29.12.2017

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN
NR. 308, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN
E PAKETAVE TË SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE QË DO TË
FINANCOHEN NGA FONDI I
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
NË SHËRBIMIN SPITALOR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas shkronjës “d”, të pikës 1, të vendimit nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen shkronjat “dh” e “e”, me këtë përmbajtje:

“dh) Paketa e trajtimit të kataraktës, sipas shtojcës 6, bashkëlidhur këtij vendimi;

e) Paketa e shërbimit të radioterapisë (me akselerator linear), sipas shtojcës 7, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



LISTA E PAKETAVE TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

SHTOJCA 6

	Kostoja 2017		Marzhi i fitimit	Çmimi i paketës
Paketa e trajtimit të kataraktës	20,157	lekë për paketë		
Në këtë paketë përfshihen				
Kryerja e interventit				

SHTOJCA 7

Paketa e shërbimeve të radioterapisë (me akselerator linear)	Kostoja 2017		Marzhi i fitimit	Çmimi
Paketa e trajtimit paliativ	7,068	lekë për seancë		
Në këtë paketë përfshihen: ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe seancat me akselerator linear				
Paketa e trajtimit adjuvant/neoadjuvant	5,780	lekë për seancë		
Në këtë paketë përfshihen ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe trajtimi me akselerator linear				
Paketa e trajtimit radikal	6,031	lekë për seancë		
Në këtë paketë përfshihen ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe trajtimi me akselerator linear.				
Paketa e trajtimit me IMRT	6,053	lekë për seancë		
Në këtë paketë përfshihen ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe trajtimi me akselerator linear (IMRT)				

**VENDIM****Nr. 816, datë 29.12.2017**

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA
DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT
DIPLOMATIK PËR MINISTRINË PËR
EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME,
TË PASURISË NR. 1/586+1-2, ZONA
KADASTRALE NR. 8380, TIRANË, PËR
T'U PËRDORUR SI SELI E
SEKRETARIATIT TË ZYRËS RAJONALE
PËR BASHKËPUNIM RINOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 118/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor”, dhe të neneve 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë të pacaktuar, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të pasurisë nr. 1/586+1-2, zona kadastrale nr. 8380, Tiranë, sipas planimetrisë bashkëlidhur, për t'u përdorur si seli e sekretariatit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR).

2. Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.


3. Me përfundimin e aktivitetit të ZRBR-së, prona t'i kthehet Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik.

4. Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe furnizimin me energji elektrike dhe ujë të zyrave të selisë së sekretariatit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor i ngarkohen Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

5. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**





**VENDIM****Nr. 818, datë 29.12.2017****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN
DHE PËRDORIMIN E FONDIT
TË VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 23.4.2011, “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 9, e vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“9. Përfshirja për vitin 2017, fondi i veçantë i njësive të qeverisjes së përgjithshme nuk përdoret për veprimtari social-kulturore dhe shpërblimin e punonjësve, me përjashtim të një shpërblimi për festat e fundvitit për punonjësit e Policisë së Shtetit. Masa e shpërblimit për këta punonjës përcaktohet nga titullari i ministrisë, në përputhje me fondin aktual, të veçantë, të miratuar për vitin 2017, por, në asnjë rast, ky shpërblim nuk tejkalon masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.”.

2. Ngarkohen njësitet e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 819, datë 29.12.2017****PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI
TË POSAÇËM SHTETËROR Z. MIRUSH
MUSA KABASHI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Mirush Musa Kabashi, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 1794, datë 26.12.2017, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasës Tefta Kallaku, duke caktuar si kujdestare apo përfaqësuese ligjore vajzën e saj, shtetasen Enerjeta Muça.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë